



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 3414 Prot.

Lezhë, më 3/4/2023

NJOFTIM

“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESES PUBLIKE NË LIDHJE ME RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, BASHKIA LEZHË”,

Bashkia Lezhë, mbeshtetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në VKM 686, date 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë Nr.201, date 31.03.2023 “Për ndërmarrjen e Nismës për rishikimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë, me procedurë të thjeshtuar”, ka ndërmarrë nismen për RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR, të miratuar me vendimin Nr.6 date 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Konkretisht procesi i rishikimit prek pjesë të qytetit Lezhë në lidhje përshtatjen e PPV me projekte publike të parashikuara nga Bashkia Lezhë, si ndertimi i një pallati sporti, ndertimi i parkut qendror të qytetit, ndertim parkimi publik nëntokesor etj. , si dhe rishikimi i treguesve të zhvillimit në pjesë të Njësisë Shëngjin me qëllim përshtatjen e PPV me kërkesat e biznesit në këte zone si dhe zhvillimin urban aktual.

Në vijim të procesit të rishikimit të PPV, Ju ftojme të merrni pjesë në dëgjesen publike, ditën e mërkure, **date 14 Prill 2023**, në ambjentet e **Qendres Kulturore të Femijeve**, në orën **14.00**. Gjatë takimit do bëhet prezantimi i dokumentave të rishikimit të darkortesuara paraprakisht me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si dhe do të mbahen shënime mendimet Tuaja, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshem, shfrytëzim të potencialeve dhe plotësimin e nevojave.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet Tuaja !

KRYETARI

Pjerin NDREU

